

# ALBERGHI DIFFUSI MODELI NË SHQIPËRI



## NJË QASJE UNIKE PËR ZHVILLIMIN E TURIZMIT TË QËNDRUESHËM


Tetor 2024

Një projekt nga Agjencia Zvicerane për  
Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC

Në partneritet me:

Zbatuar nga:

Me kontributin e:





# KONCEPTI ALBERGHI DIFFUSI

## HYRJJE

*Albergo Diffuso* (AD) është një koncept inovativ që synon të transformojë fshatra të braktisura me potencial të pashfrytëzuar turistik, në destinacione autentike për turistët. I prezantuar për herë të parë në Itali në fillim të viteve 1980, ky koncept u zhvillua dhe u zbatua nga Shoqata Alberghi Diffusi (ADI).

AD është konceptuar si mënyrë për të promovuar turizmin në fshatrat e vegjël dhe qendrat historike të qyteteve, duke ruajtur karakterin e tyre unik. Modeli garanton që zhvillimi i turizmit të ndodhë në harmoni me komunitetet lokale, pa çenuar stilin e jetesës, bukurinë natyrore dhe atraksionet e këtyre zonave.

Një tipar dallues i modelit “*Albergo Diffuso*” ose “*Hotel i Shpërndarë*”, ka të bëjë me integrimin e akomodimeve brenda zonave të banuara. Vizitorët qëndrojnë në shtëpi të shpërndara në të gjithë fshatin, duke i lejuar ata të përjetojnë kulturën vendase dhe të jetojnë eksperiencën si banorë të përkohshëm, dhe jo thjesht si turistë.

## MODELI I BIZNESIT

Modeli AD përcaktohet nga karakteristika specifike dhe kushte që duhet të përmbushen paraprakisht, që shërbejnë si komponentë thelbësorë të shërbimeve unike të mikpritjes. Ndonëse këto kushte janë përcaktuar dhe zbatohen plotësisht në Itali, kuadri ligjor përkatës për modelin AD në Shqipëri është ende në zhvillim e sipër.

**Një menaxhim i vetëm:** Akomodimi funksionon sipas një modeli të vetëm biznesi duke garantuar menaxhim të unifikuar.

**Shërbimet e hotelit:** Dhomat ose njësitë e banimit janë të shpërndara nëpër ndërtesa të veçanta ekzistuese brenda një qendre të vjetër të qytetit, të cilat ofrojnë të gjitha shërbimet e një hoteli klasik.

**Zonat e përbashkëta:** Hapësira të tilla si hapësirat e pritjes, sallat komunale, baret dhe restorantet janë projektuar për tu përdorur nga vizitorët, duke ofruar shërbime të përbashkëta.

**Afërsia e ndërtesave:** Distanca maksimale ndërmjet njësite të banimit dhe njësisë kryesore të shërbimeve të mikpritjes (aty ku ofrohen shërbimet kryesore) nuk duhet të tejkalojë 200 metra.

Komunitet i gjallë: Fshati ose qendra e vjetër e qytetit duhet të jetë e banuar, duke ofruar një mjedis të gjallë dhe aktiv.

**Mjedis autentik:** akomodimi integrohet pa probleme me komunitetin dhe kulturën lokale, duke u ofruar mysafirëve një përvojë autentike.

**Identiteti i dalluar:** Struktura ruan një identitet të qartë dhe të njëtrajtshëm, duke ofruar shërbime koherente në të gjitha njësitë.

**Turizëm i qëndrueshëm:** Qasja menaxheriale përputhet me territorin lokal dhe vlerat e tij kulturore. Modeli Albergo Diffuso përfaqëson një model unik mikpritjeje, duke integruar turizmin me mjedisin, kulturën dhe komunitetin lokal.

## PËRFITIMET

Modeli AD ofron përfitime të shumta, duke shërbyer si një koncept unik mikpritjeje, që dallon nga modelet klasike të hoteleve dhe rezorteve. I krijuar për të promovuar turizmin në fshatrat dhe qendrat historike të qyteteve, modeli AD ruan karakterin autentik të këtyre zonave pa qenë nevoja për ndërtim të reja, duke u përqendruar në organizimin dhe shfrytëzimin e strukturave ekzistuese.

Si një model për zhvillimin e turizmit në territore të ndryshme, Hotelit i Shpërndarë funksionon si një rrjet, duke bërë bashkë shtëpitë dhe aktivitetet lokale. Ai ofron shërbime nëpërmjet riorganizimit dhe përmirësimit të atyre ekzistuese, duke prezantuar gjithashtu struktura të reja. Kjo qasje inovative nxit bashkëpunimin brenda komunitetit dhe zhvillon ekonominë vendase.

Modeli AD është pjesë e një teorie më të gjerë të zhvillimit të turizmit, e rrënjësuar në filozofinë e mikpritjes që dallon nga praktikat tradicionale. Koncepte të tilla si “vizitor”, “qëndrueshmëri”, “komunitet i gjallë”, “stili i jetesës në fshat”, “banor i përkohshëm”, “autenticitet”, dhe “terrorial”, jo vetëm që janë thelbësore, por mbartin një kuptim të veçantë në modelin AD. Këto ide ripërcaktojnë qasjen ndaj turizmit, duke nxjerrë në pah përvojën lokale gjithëpërfshirëse dhe autentike.

AD adreson kërkesën në rritje për përvoja autentike turistike, duke nxitur strukturimin e ofertave lokale dhe duke ngjallur interesin për ushqimin tradicional, recetat, veprat artizanale, eventet kulturore dhe burimet historike dhe mjedisore. Duke rilidhur vizitorët me trashëgiminë vendase, modeli AD rigjallëron komunitetet duke ruajtur esencën e tyre.

Një model AD sjell përfitime të shumta për fshatrat në të cilat zbatohet. Duke shfrytëzuar shtëpitë e pabanuara, modeli AD nxit rimëkëmbjen dhe rinovimin e këtyre zonave, ku turistët u japin jetë rrugëve dhe hapësirave. Ai gjithashtu i ndihmon banorët vendas që ta shohin jetën e tyre të përditshme sipas një këndvështrimi të ri, duke rritur vlerësimin e tyre për kulturën dhe traditat lokale.

Për më tepër, shumë vizitorë që apasionohen me fshatin dhe stilin e tij të jetesës, shpesh blejnë shtëpi pushimi ose zgjasin qëndrimet e tyre. Mediat shpesh theksojnë ndikimin pozitiv që modeli AD ka në imazhin dhe ekspozimin e fshatrave në të cilat ai zbatohet, duke kontribuar më tej në rigjallërimin e tyre.

## HISTORI SUKSESI

**2004:** Kongresi i parë kombëtar në Campobasso, Itali.

**2009:** Përfaqësimi i ADA Kombëtare në Mase.

**2010:** Mirënjohja ndërkombëtare e modelit AD në World Travel Market në Londër.

**2011:** Kontribut në legjislacionin kroat të modelit AD.

**2012:** Shpallja e testit të parë spanjoll, Salamanca.

**2018:** Zbatimi i modelit AD në Gjermani.

**2018:** Zbatimi i modelit AD në Japoni.

Kërkesat për zbatimin e modeleve AD në: Irlandë, Shqipëri, Francë, Sllovakia, Serbi, San Marino, Gjeorgji dhe Kinë.

# 'ALBERGHI DIFFUSI' NË SHQIPËRI

## ZBATIMI AKTUAL

Në maj të vitit 2023, në Krujë u shpall zyrtarisht modeli i parë 'Albergo Diffuso' në Shqipëri, i njohur si **Albergo Diffuso Kruja**.

Në vitin 2022, një ekip ekspertësh nga *Shoqata Alberghi Diffusi dhe AD Balkan* realizuan një vlerësim të fshatrave në Shqipëri, të përfshirë në "Strategjinë e 100 fshatrave", për të përcaktuar fizibilitetin e zbatimit të modelit AD në të gjithë vendin. I drejtuar nga Prof. Giancarlo Dall'Ara, President i Shoqatës, ekipi vizitoi disa fshatra në **Gjirokastrë, Korçë, Kukës dhe Dibër**.

Vlerësimi u zhvillua në disa faza, duke filluar me një vlerësim paraprak të dhjetë fshatrave, për të vijuar në fazën tjetër me një vlerësim më të thelluar të pesë fshatrave të përzgjedhur. Ndër fshatrat e vlerësuar si me potencial për të zhvilluar modelin AD u përzgjedhën: **Rabdisht dhe Bellovë** në Dibër, **Qytezë** në Korçë, **Leus** në Përmet, **Roshnik dhe Kështjella e Beratit** në Berat, si dhe **Dhoksat, Mingul dhe Pazari i Gjirokastrës** në Gjirokastrë.

Pas vizitës fillestare, Prof. Dall'Ara theksoi potencialin premtues për zhvillimin e modelit AD në Shqipëri, duke vënë në dukje se biznesat vendase kishin shprehur interes të lartë për të eksploruar konceptin dhe gatishmëri për të bashkëpunuar.

Modeli AD është veçanërisht i përshtatshëm për të përmbushur nevojat e turistit "të gjeneratës së tretë", si një turist i cili nuk kërkon thjesht të vizitojë një destinacion, por edhe ta përjetojë atë plotësisht. Këta turistë synojnë të krijojnë marrëdhënie të reja, jo vetëm me vizitorët e tjerë, por veçanërisht me banorët vendas. AD ofron një qasje të zhvillimit të qëndrueshëm, i cili minimizon ndikimet negative mjedisore dhe nxit lidhje më të forta me komunitetin.

## MBËSHTETJA NGA QEVERIA DHE KOMUNITETI

Shqipëria ka njohur ligjërisht modelin inovativ të biznesit AD, si një prej kategorive të strukturave akomoduese, në ligjin Nr. 30/2024 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 93/2015 "Për turizmin" (i ndryshuar)". RisiAlbania dhe Albergo Diffuso Ballkans kanë luajtur një rol kyç në këtë zhvillim historik, duke prezantuar këtë inovacion në qytetet e vogla në Shqipëri, duke rigjallëruar komunitetet dhe duke krijuar mundësi të qëndrueshme punësimi për të rinjtë.

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM) po zbaton ndryshime që do të përqafojnë dhe rregullojnë zyrtarisht këtë model mikpritjeje. Vendimi për të përfshirë modelin AD në ofertën turistike të Shqipërisë përbën një moment historik të rëndësishëm për zhvillimin e sektorit të turizmit në vend. Kjo lëvizje pritet të vijojë me zhvillimin e një kornize gjithëpërfshirëse rregullatore, duke përcaktuar standarde dhe udhëzime të qarta për funksionimin e akomodimeve AD, të cilat do sigurojnë përputhje me praktikën më të mira të industrisë dhe do të përmbushin pritshmëritë e turistëve dhe komuniteteve lokale.

Një prej rezultateve më domethënëse të kësaj njohjeje është përfshirja e mundshme e modelit AD në skemat e financimit publik dhe programet e tjera nxitëse. Me një kuadër rregullator të qëndrueshëm, këto tipe akomodimesh do të kenë akses në mbështetje financiare, duke ndikuar në zhvillimin e tyre dhe duke nxitur investime të mëtejshme në turizmin e qëndrueshëm. Kjo do të shërbejë si një shtysë për sektorin e turizmit në Shqipëri, duke tërhequr vizitorë që janë në kërkim të përvojave unike e kulturore.

Teksa Shqipëria përparon në legjislacionin e saj të turizmit, integrimi i Alberghi Diffusi nxjerr në pah angazhimin e vendit ndaj modeleve inovative dhe të qëndrueshme të turizmit. E ardhmja duket premtuese për modelin AD në Shqipëri, ndërsa ky model i afrohet njohjes së plotë ligjore dhe përshtatjes së gjerë me sektorin kombëtar të turizmit.



Pavarësisht interesit dhe vullnetit të fortë për të zhvilluar modelin AD në vendet e përzgjedhura, ekipi u përball me disa sfida, të cilat duhen adresuar për të arritur zbatimin e suksesshëm të modelit në Shqipëri. Sfidat kryesore përfshijnë:

- Kufizimet strukturore dhe fizike:** Shumë prej godinave ekzistuese (bujtinat) kanë nevojë për modifikime thelbësore për të akomoduar të gjitha shërbimet dhe lehtësitë, të nevojshme për modelin AD.
- Pengesat burokratike:** Vonesat në projektet e restaurimit dhe pengesat burokratike, veçanërisht në lidhje me plotësimin e afateve kohore të kërkuara, kanë penguar progresin në këtë drejtim.
- Mungesa e ekspertizës manaxheriale:** Ekziston një hendek i dukshëm në kapacitetin manaxherial për të përfshirë në mënyrë efektive funksionet e ndryshme, të kërkuara nga modeli AD.

## PERSPEKTIVA E ARDHSHEME

Fazat e vlerësimeve të vendndodhjeve potenciale të identifikuar, të përqendruara në vlerësimin e përshtatshmërisë së tyre për të zbatuar modelin Albergho Diffuso, çuan në përzgjedhjen e dy fshatrave: Rabdisht në Dibër dhe Qytezë në Korçë.

Këto destinacione kanë treguar se kanë potencial për të zbatuar në mënyrë të suksesshme modelin AD dhe do t'i bashkohen AD Krujës për të ofruar eksperiencën unike të "Hotelit të Shpërndarë" në Shqipëri.

Zona dhe fshatra të tjerë në Shqipëri që kanë potencialin për të zbatuar modelin AD, duhet të eksplorojnë më tej.

"Ne kemi ndeshur disa fshatra tipike dhe autentike shqiptare, të cilët kanë shumë të përbashkëta me fshatrat në jug të Italisë ku ky model është zbatuar me sukses."

Giancarlo Dall'Ara,  
President i ADA-s

"Kemi filluar tashmë t'u afrojmë mysafirëve tanë një eksperiencë unike të të jetuarit në fshatin tradicional Dhoksat dhe jemi të lumtur për shkëmbimin që patëm me ekipin e Alberghi Diffusi"

Roland Koci, Pronar i një bujtine në Dhoksat





"Detaje të punuara bukur dhe të restauruara mirë"

Turist AD Kruja

"Albergo Diffuso i jashtëzakonshëm (hotel i shpërndarë)"

Turist, AD Kruja

"Osi ka ndërtuar një perlë të vërtetë në zemër të Krujës, në një mjedis spektakolar, me kujdes dhe vizion të jashtëzakonshëm për potencialin e turizmit: i qëndrueshëm, respektues i traditës, autentik dhe me vlerë të shtuar për komunitetin"

Turist, AD Kruja



# KRUJA HISTORIA E NJË MODELI TË SUKSESSHËM AD

## IMPAKTI I AD KRUJA

Ngritja e Albergo Diffuso Kruja, modeli i parë AD në Shqipëri, shënon një moment historik jo vetëm për zhvillimin e sektorit të turizmit shqiptar por të të gjithë rajonit të Ballkanit, duke qenë modeli i parë AD i zbatuar në Ballkan.

AD Kruja ofron një përvojë unike turizmi, që shërben si një precedent në Shqipëri dhe më gjerë në rajon. Ky model luan një rol kyç në rigjallërimin e komuniteteve lokale dhe promovimin e praktikave të qëndrueshme të turizmit.

Në dallim nga hotelet klasike apo bujtinat, koncepti AD thekson ruajtjen e trashëgimisë kulturore, turizmin e qëndrueshëm dhe mbështetjen për ekonominë lokale, pa patur nevojë për ndërtimin e godinave të reja.

Vizitorët në AD Kruja mund të përjetojnë magjinë autentike të qytetit, të eksplorojnë monumentet e tij historike dhe të ndërveprojnë me komunitetin vendas, duke e bërë qëndrimin e tyre një përvojë të vërtetë përmbushëse. AD Kruja është përmendur nga National Geographic si një prej akomodimeve që "duhet vizituar" për vitin 2024.

## MËSIMET E NXJERRA

Mësimet kryesore të nxjerra nga zbatimi i modelit AD Kruja:

- Rritja e ndërgjegjësimit:** Fillimisht, bizneset lokale dhe pronarët e strukturave nuk i kuptonin përfitimet që mund të merrnin nga zbatimi i modeleve të qëndrueshme në turizëm si modeli AD. Nëpërmjet edukimit dhe komunikimit, ata tani vërejnë potencialin për të zgjeruar strukturat akomoduese dhe për t'u bërë pjesë e tregjeve e norma të larta kthimi.
- Përmirësimi i aftësive:** Shumë banorëve vendas u mungonin aftësitë e biznesit, të nevojshme për të pasur sukses në këtë drejtim. Ofrimi i trajnimeve dhe vizitave studimore i ndihmoi ata të fitonin njohuritë dhe përvojën e nevojshme për të drejtuar dhe menaxhuar biznese në fushën e turizmit.
- Nxitja e bashkëpunimit:** Gjetja e një personi të gatshëm për të marrë përsipër përgjegjësinë dhe risikun e fillimit të biznesit AD përbënte një sfidë. Megjithatë, përmes diskutimeve dhe ndërtimit të marrëdhënieve të besimit, komuniteti u tregua bashkëpunues duke lejuar një person të ri dhe të aftë të menaxhonte biznesin, gjë që çoi në zbatimin e procesit me lehtësi.
- Sigurimi i financimit:** Suksesi i projektit u mbështet nëpërmjet ndërthurjes së investimeve private me financimin publik, i tillë si "Bonusi i Rijetëzimit" nga Ministria e Kulturës, për të siguruar stabilitet financiar dhe zhvillim.
- Trajtimi i çështjeve të pronësisë:** Problemet ligjore në lidhje me çështjet e pronësisë së pronave u zgjidhën nëpërmjet nxitjes së pronarëve të pronave që të bashkëpunojnë dhe të bien dakord për arritjen e synimeve të përbashkëta, duke e bërë projektin të funksionojë më mirë.

## NXITJA E BASHKËPUNIMIT

Idea e ngritjes së modelit Albergo Diffuso në Shqipëri, veçanërisht në Krujë, erdhi në shtator të vitit 2020, pas një vlerësimi të detajuar dhe gatishmërisë së grupeve të interesit për të marrë pjesë në këtë iniciativë. **Shtatë pronarë të shtëpive vendase** ranë dakord të bashkëpunonin, nga ku tre prej tyre gjatë vitit të parë dhe katër të tjerë në vitin e dytë.

**AD Kruja u regjistrua ligjërisht** si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, në pronësinë dhe administrimin e një prej pronarëve të shtëpive, i zgjedhur përmes një marrëveshjeje të përbashkët.

Ngritja e AD Kruja u realizua përmes disa fazave kryesore:

- Restaurimi i godinave:** Hapi i parë konsistoi në restaurimin e disa strukturave kyçe, duke përfshirë shtëpinë kryesore dhe recepsionin, si dhe rinovimin e shtëpive të tjera. Një prej projekteve ishte Shtëpia e Piktorit, e cila tani ofron për vizitorët dy dhoma gjumi dhe një galeri arti.
- Regjistrimi ligjor dhe Bashkëpunimi:** Pas regjistrimit zyrtar të AD Kruja si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, u bënë përpjekje për të bashkëpunuar me institucionet përkatëse qeveritare për të mbështetur veprimtarinë e saj dhe për të zgjeruar më tej modelin. Këtu përfshihet bashkëpunimi me UNOPS dhe Ministrinë e Kulturës për të restauruar dhe rigjallëruar dy shtëpi dhe për të përfshirë Hamamin e Vjetër si atraksion turistik, në partneritet me Ministrinë e Kulturës.
- Përpjekjet promovuese dhe ndërgjegjësuese:** U organizuan aktivitete promovuese në bashkëpunim me grupet e tjera të interesit në Krujë, për të diskutuar mbi përfitimet dhe sfidat e modelit AD, si dhe zbatimin e tij. Këto përpjekje kishin si qëllim rritjen e ndërgjegjësimit dhe garantimin e njohjes zyrtare të modelit AD në kuadrin ligjor të Shqipërisë.
- Shpallja zyrtare:** AD Kruja u shpall zyrtarisht më 21 qershor 2023, duke shënuar kështu modelin e parë Albergo Diffuso të zbatuar në Shqipëri. Aktiviteti lançues u ndoq nga figura të njohura, si Ambasadorja e Zvicrës në Shqipëri, Zj. Ruth Huber; Zëvendësi Ministri i Turizmit dhe Mjedisit, Zj. Vilma Bello; Presidenti i Shoqatës Ndërkombëtare Albergo Diffuso, Prof. Giancarlo Dall'Ara; dhe Nënkryetari i Bashkisë Krujë, Z. Ilir Loci.

E pozicionuar brenda kalasë historike të Krujës, AD Kruja përmban 13 dhoma për vizitorët, të shpërndara në tre godina të restauruara, së bashku me një ambient pritjeje (reception) dhe një restorant. Ky moment historik përfaqëson një hap të rëndësishëm në vijim për sektorët e turizmit dhe mikpritjes në Shqipëri.

### INDIKATORËT E PERFORMANCËS SË AD KRUJA PËR VITIN 2023-2024



### IMPAKTI I AD KRUJA NË RAJONIN E BALLKANIT



# POTENCIALI PËR RRRITJE

## HAPAT PËR TU KTHYER NË NJË 'ALBERGO DIFFUSO'

AD Balkan është një kompani konsulence që mbështet dhe promovon krijimin dhe përhapjen e modelit AD, si dhe shpërndan njohuritë dhe kompetencat në Shqipëri dhe në zonën e Ballkanit, përmes seminareve, konferencave, eventeve, si dhe projekteve të zhvillimit të turizmit.

Shërbimet që AD Balkan kryen për bizneset dhe autoritetet lokale kontribuojnë në zbatimin e modelit AD, të cilat variojnë nga planifikimi i turizmit territorial deri te analizat e fizibilitetit, nga kërkimi paraprak i tregut deri te krijimi i projekteve të turizmit të qëndrueshëm, si dhe trajnimi për operatorët. AD Balkan realizon propozime specifike të dakorduara mbi bazën e nevojave specifike të formuluar nga aplikanti, në lidhje me verifikimin e standardeve të ofertës, planifikimin, trajnimin turistik dhe certifikimin e strukturave me emërtimin "Albergo Diffuso".

### Faza 1: Shprehja e interesit

Kjo fazë konsiston në mbledhjen e shprehjeve të interesit nga pronarët e bujtinave, godinave ose njësive të akomodimit, të cilët dëshirojnë përfshihen në proces dhe të bëhen pjesë e një destinacioni AD.

### Faza e dytë: Vlerësimi paraprak

Në këtë fazë mbledhet informacion përmes kërkimit, inspektimeve fillestare dhe vizitave në terren, si dhe organizohen takime dhe intervista me pronarët e pronave dhe grupet e tjera të interesit, për të vlerësuar destinacionet e mundshme që mund të përmbushin kriteret për të ngritur një model AD.

### Faza e tretë: Vlerësimi sipas kriterëve

Këtu realizohet një vlerësim i detajuar i kriterëve të modelit AD, duke përcaktuar kërkesat specifike të nevojshme që një destinacion duhet të përmbushë për të funksionuar sipas modelit AD. Kjo përfshin vlerësimin e pronave dhe volumin e nevojshëm të punimeve të restaurimit dhe ndërhyrjes.

### Faza e katërt: Përzgjedhja dhe formalizimi

Në këtë fazë ndodh përzgjedhja e fshatrave AD, e pasuar nga themelimi ligjor i entitetit. Marrëveshjet formalizohen për të përcaktuar strukturën e menaxhimit dhe funksionimit të destinacionit AD.

### Faza e pestë: Punimet e restaurimit

Këtu zbatohen punimet e restaurimit dhe rinovimit në pronat e zgjedhura të modelit AD, për të garantuar që ato plotësojnë standardet e kërkuara dhe mund të shërbejnë si struktura akomodimi.

### Faza e gjashtë: Funksionimi i AD-së.

Pas përfundimit të restaurimit, destinacioni AD fillon funksionimin e tij, duke ofruar një përvojë unike "Hoteli të Shpërndarë" për vizitorët.

## VENDNDODHJET POTENCIALE DHE PERFITIMET

Fshatrat e përzgjedhur që përpunohen me modelin AD dhe disa tipare karakteristike të tyre janë:

- **Bellovë, Dibër:** I njohur për mikpritjen e tij të ngrohtë, ndjenjën e fortë të komunitetit dhe përkushtimin e lartë për ruajtjen e traditave dhe kulturës vendase.
- **Rabdisht, Dibër:** Ofron një gamë të gjerë shërbimesh për vizitorët, shoqëruar me mikpritje, një hapësirë të dedikuar muzeale dhe një fokus të lartë në shpirtin menaxherial dhe atë sipërmarrës.
- **Qytezë, Korçë:** Niveli i lartë i interesit nga vendasit, përpjekje të vazhdueshme për rijetëzimin e fshatit, përkushtim ndaj zhvillimit të qëndrueshëm dhe ekzistenca e një historie të pasur si fshat historik.
- **Roshnik, Berat:** Gatishmëri dhe interes i lartë për zhvillimin e modelit AD, me fokus në ndarjen e traditave të shumta dhe historisë së fshatit.
- **Vila Caka, Berat:** E njohur si një monument kulture, ky vend përmban shtëpi tradicionale, duke ofruar një lidhje të fortë me trashëgiminë vendase.

Pas vlerësimit të mëtejshëm, fshatrat që ofrojnë më shumë potencial për ngritjen dhe zbatimin e modelit AD janë Rabdishti në Dibër, i shquar për frymën e bashkëpunimit me komunitetin, si dhe Qytezë në Korçë, i konsideruar si "perla e vogël", një fshat tërheqës kufitar, ideal për destinacionin AD.

Kontakt:

### AD Balkan

Znj. Brunilda Licaj, Administratore


Tel: +355 (0) 692092590

Email: [info@ad-balkan.com](mailto:info@ad-balkan.com)

Web: [www.ad-balkan.com](http://www.ad-balkan.com)

ZHVILLO MODELIN  
TËND  
ALBERGO DIFFUSO

KAP  
MUNDËSINË!





## REFERENCAT

AD, un modello di ospitalità italiano nel mondo - (Dall'Ara 2019)

Il Manuale dell'Albergo Diffuso - (Dall'Ara 2015)

Alberghi Diffusi Model as an opportunity for potential investors - (Partners Albania for Change and Development 2021)

AD Balkan reports, in the frame of "Promotion and Implementation of the AD Model in Albania" project.

Ligj Nr. 30/2024 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 93/2015, "Për turizmin" (i ndryshuar)"

Albergo Diffuso, developing sustainable tourism by modernising tradition - (RisiAlbania 2023)

Albergo Diffuso: un nuovo capitolo per il turismo albanese - (Albergo Diffuso 2023)

Kruja Albergo Diffuso: Commuoversi di fronte alla natura - (Albergo Diffuso 2023)

Lonely Planet presenta il primo Albergo Diffuso dei Balcani - (Albergo Diffuso 2023)


How Alberghi Diffusi turn villages into hotels - (Smithsonian Magazine; 2023)

Shqipëria ndërmerr hapa inovativë: Alberghi Diffusi një strukturë akomodimi turistike e njohur ligjërisht - (RisiAlbania 2023)

Revitalizing Cultural Heritage: Albania's First Albergo Diffuso Opens in Kruja! - (RisiAlbania 2023)

Turizmi në fshatra - (AD Balkan 2021)

Here are the hotels we love for 2024 - (National Geographic 2024)



Ky publikim është krijuar nga Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim. Pikëpamjet dhe konkluzionet e përfshira këtu nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të Qeverisë Zvicerane ose të Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDG.

